¹ Per keto raste do te zbatohet ky çmim vetem kur permbushen kriteren te parashikuara ne kete pike dhe shoqerohen me dokumenta ligjor justifikues.

² Per keto raste do te zbatohet ky çmim vetem kur permbushen kriteren te parashikuara ne kete pike dhe shoqerohen me dokumenta ligjor justifikues.

g- Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar ³ vetem per sipërfaqet e banimit	26.810	0.05	0.40	10.72
---	--------	------	------	-------

Ne zbatim te VKM Nr.132 date 07.03.2018,dhe për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, parashikohet:

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. PAGESA e taksës bëhet çdo muaj apo, për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.
6. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:
 - a) pronat e shtetit dhe të njëjstëve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
 - b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore
 - c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
 - ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
 - d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
 - dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
 - e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
 - ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paafatë për punë;
 - f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
 - g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave,.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- 0.05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- 0.2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- 30 % e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

³ Per keto raste do te zbatohet ky çmim vetem kur permbushen kriteren te parashikuara ne kete pike dhe shoqerohen me dokumenta ligjor justifikues.

I.2.2- Taksa mbi tokën bujqësore

Përkufizimi: "Tokë bujqësore" është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave që e vërtetojnë atë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës etj. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore (Lekë/ha/vit)
I	4200
II	3500
III	2800
IV	2300
V	1900
VI	1600
VII-X	1400

Detyrimi për pagesë: Taksa mbi tokën bujqësore është një detyrim vjetor.

Për bizneset që ushtrojnë aktivitetin në tokë bujqësore, koeficienti do aplikohet në kategorinë e pare 4200 lekë/ha/vit.

Përjashtime: Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufutrore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi pasurinë është Drejtoria e tatimeve dhe kadastra e Bashkisë Cërrik.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme ia përcjell këtë informacion Drejtorisë së tatimeve e të ardhurave për llogaritjen e detyrimit.

I.2.3- Taksa mbi Truallin

Përkufizimi: Truall është një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Nr	Taksa mbi truallin	Niveli i taksës sipas ligjit
1	Për qëllime banimi nga individë	0,14 lekë/m ² /vit
2	Për qëllime biznesi	12 lekë/m ² /vit

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e tatimeve të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrënë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

I.3 Taksa e fjetjes në hotel

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategori të si më poshtë: a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; dh)“Resort”; e)“Qendër kurative”; ë)“Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë.

Janë subjekt i Taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

Niveli i taksës është si më poshtë:

Nr	Taksa e fjetjes në hotel	Niveli taksës (lekë/natë /qëndrimi /person)
1	Hotelet 4-5 yje	105
2	Bujtinë,fjetin,motel dhe cdo njësi tjeterakomoduese sipas ligjit për Turizmin,për cdo natë fjetje	35

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli.Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

I.4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës: Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe nën kategorive për klasifikimin e investimeve, është si mëposhtë:

Në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,ligjit 119/14”Per te drejtat e informimit Neni 7” Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar , ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar,ligjit 9632 date 30.10.2006 “Per Sistemin e taksave vendore”,neni 27 ‘‘Taksa e ndikimit ne infrastrukture’’ pika pika 3 .a,ndryshuar me ligjin ligjin Nr. 95/2018 neni 9 pika 3,3a. ligjit Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.VKM Nr 408 date 13.05.2015’’Per Miratimin e Rregullores se zhvillimit te Territorit’’ e ndryshuar, Drejtoria e Planifikimit te Territorit duke pasur ne vemendje nivelin e te ardhurave te banoreve te bashkise Cerrik dhe qellimin per nje pershtatje me te mire te llojit te tipollogjise dhe funksionin te objektit, e punimeve ndetimore te cilat kerkohen te kruhen ne perputhje me kerkeat per llojet elejeve ne sistemin-eleje si dhe VKM 457 date 29.06.2022 “Per disa Ndryshime ne VKM 408.date 13.05.2015 , si dhe me miratim të Kryetarit të Bashkisë:

Taksat e ndikimit ne infrastrukture per ndertimet e reja ne bashkine Cerrik 2026		
I	Emërtimi	Niveli

A1	Ndërtime për banim e shërbim me qëllim e fitimi nga firmat e ndërtimit.	4% e çmimit të shitjes në fuqi si pas tabela Nr1 te Udhëzimit Nr1 date 10.09.2025 e Entit Kombëtar të Banesave.
A2	Rikonstruksion i ndërtime për banim e shërbim me qëllim e fitimi nga firmat e ndërtimit	4% e çmimit të shitjes në fuqi si pas tabela Nr2 te Udhëzimit Nr3 date 28.12.2016 e Entit Kombëtar të Banesave
A3	Ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit , të industrisë,individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës,	2% të vlerës së kosos se preventivit te punimeve llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar per informatizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim " por jo me pak se 2% e vleres se kosos leke/m2 sipas tabela Nr1 te Udhëzimit Nr1 date 10.09.2025 e Entit Kombëtar të Banesave.
A4	Strukturë te reja për qëllime publike, përjashtohet BashkiaCërrik	2 % të vlerës së investimit me preventiv te punimeve llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar per informatizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim "
A5	Rikonstruksione e struktura të ndryshme per qellime publike (perjashtohet bashkiaCërrik)	2% e vlerës së preventivit sipasV.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar per informatizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim "
A6	Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin,	1% e vlerës së investimime preventiv te punimeve llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar per informatizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim "
A7	Struktura me funksion privat (prodhim , tregtimi e shërbimi) qe nuk perfshihen ne ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dheblegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin,	2% të vlerës së investimit sipas çmimit të entit tëbanesave në fuqi, behet 2 % të vlerës së kosos se preventivit te llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar per informatizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim "
A8	Projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritëdhe pajisjet për këto projekte të ndërtimeve të reja është	0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;
A9	Rehabilitim rrugësh ujësjellsash kanalizime, përjashtohet BashkiaCërrik	2%të vlerës së kosos se preventivit te llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar per informatizimin e manualit te çmimeve per zerat e punimeve ne ndertim

A10	Ndërtim për banim e për qëllime jo fitimi.	1% të vlerës së kostos së preventivit të punimeve llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zerrat e punimeve në ndërtim " pur jo më pak 1% e vlerës së kostos leke/m2 sipas tabela Nr1 të Udhëzimit Nr1 date 10.09.2025 e Entit Kombëtar të Banesave.
A11	Rikonstruksione për ndërtim për banim e për qëllime jo fitimi	1 % të vlerës së kostos së preventivit të llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zerrat e punimeve në ndërtim "
A12	Punime ndërtimore dhe të infrastrukture për ndryshimin e funksionit ekzistues të objektit(ne ndërtesa nuk do të preket elementet konstruktiv)	2% të vlerës së investimit sipas çmimit të entit të banesave në fuqi, behet 2 % të vlerës së kostos së preventivit të llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zerrat e punimeve në ndërtim "
A13	Apikim për Leje për ndryshim funksioni të objektit ekzistues në të cilën nuk do të kryhen punime ndërtimore opo të infrastruktures e deklaruar para noterit (deklarate	0%(zero) Paguhet vetëm tarifë 100leke/m2 për shqyrtim dokumentacini
A14	.Banesa për Individët që trajtohen nga emergjencat civile	0%
A15	Objekte që zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si agro-turizëm sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit	2 % të vlerës së kostos së preventivit të llogaritur V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zerrat e punimeve në ndërtim "por jo më pak se 2% e vlerës së kostos leke/m2 sipas tabela Nr1 të Udhëzimit Nr1 date 10.09.2025 e Entit Kombëtar të Banesave.
A16	A16.Vendosje antenash (konstruksioni metalik)	2 % të vlerës së kostos së preventivit të llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zerrat e punimeve në ndërtim "
A17	Vendosje reklama e promovion (private publike)	2 % të vlerës së kostos së preventivit të llogaritur sipas V.K.M Nr216 dt.13.04.2023"Sistemi i integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zerrat e punimeve në ndërtim "
II	Takse për objektin në proces legalizimi dhe procedura e mbajtjes së tyre	
1	Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, teksta e ndikimit në infrastrukture për ndërtimet e reja është 0.5% e vlerës së investimit në bazë të çmimit të Entit të Banesave	
II/1	Kategoritë dhe nenkategoritë për më tepër se 1 objekte në proces legalizimi janë :	
1	Strukture banimi	3% të vlerës së kostos mesatare të ndërtimit sipas tabela Nr1 të Udhëzimit Nr3 date 28.12.2016 e Entit Kombëtar të Banesave

2	Strukture me funksion sherbimi dhe administrative	3% të vlerës së kostos mesatare të ndertimit sipas tabelës Nr1 të Udhëzimit Nr3 datë 28.12.2016 e Entitetit Kombëtar të Banesave
3	Strukture për qellime publike - shkollë, kopshte, spitale (private ose publike)	2% të vlerës së kostos mesatare të ndertimit sipas tabelës Nr1 të Udhëzimit Nr3 datë 28.12.2016 e Entitetit Kombëtar të Banesave
<i>Për zbatimin e këtij seksioni ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Territorit, Zhvillimit dhe Aplikimit të Projekteve, Drejtoria e Financës</i>		

Tarifa për shërbimet që kryen DPZHT Bashkia Cerrik për vitin 2026			
III	Emertimi	Njesi	Vlera
1	Tarifë për dhenie çertifikate përdorimi		
1.1	Objekt për banim	lekë/m ²	100
1.2	Objekt për biznes	lekë/m ²	120
2	Tarifë shërbimi e shqyrtim dokumentacioni		
2.1	Tarife për shqyrtim leje ndertimi strukture deri 250m ²	leke/m ²	25
2.2	Tarife për shqyrtim leje ndertimi për strukture > 250m ²	leke/m ²	20
2.3	Tarife për shqyrtim leje ndertimi për strukture sociale ekonomike	leke/m ²	30
2.4	Tarife për shqyrtim i lejes ndryshim funksioni të objektit ekzistues në të cilin nuk do të kryhen punime ndertimore apo të infrastrukturës e deklaruar para noterit (deklarate noteriale) nga pronari i objektit niveli i tarifës do të jetë 100(njeqind) leke/m ²	leke/m ²	100
3	Leje zhvillimor për ndertime të reja		
3.1	Struktura për banim deri në 250m ²	lekë/m ²	80
3.2	Struktura për ndertim të ri për banim mbi 250m ²	leke/m ²	100
3.3	Ndertim i ri (Strukture me funksion shërbimi dhe administrative, publike - shkollë, kopshte, spitale, private ose publike,) përjashtohet bashkia Cerrik	leke/m ²	120
3.4	Rikonstruksion apo ndertim i ri i rrjetit të infrastrukturës, infrastrukturë, rrugë, kanalizime, ujësjellës, linja e tensionit të lartë, të mesëm e të ulët, linja e audiovizimeve, interneti (përjashtohet bashkia Cerrik)	leke/1 leje	15000
4	Leje ndertimi për punime me vetëdeklarim, sipas pikës 7 të VKM 408 datë 13.05.2015 ndryshuar	leke.për 1 leje	10000
5	Tarifë për miratim kërkesë për punimet sipas kreut I "Dispozita të përgjithshme" Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisje me lejen dërtimi, VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar VKM Nr.672 datë 29.07.2015, VKM Nr.1043 datë 16.12.2015, VKM Nr.271 datë 6.4.2016, VKM Nr.231 datë 21.03.2017, VKM Nr.355 datë 19.04.2017, VKM Nr. 693, datë 2.10.2019, VKM Nr. 796, datë 11.12.2019, VKM Nr. 457, datë 29.06.2022 dhe VKM 377 datë 12.06.2024 VKM Nr.685, datë 6.11.2024 Neni 6. Ndërhyrje/punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndertimi		

5.1	Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje, që përfshijnë VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar		
5.1.1	.Ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre		
5.1.2	Rifreskimi i lyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale, që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese, si dhe vendosja e skelave	leke/miratim njoftimi	3000
5.1.3	Ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e eficiencës energjetike dhe akustike në një strukturë ekzistuese, (sistemimi kapot) që nuk prekin sistemin konstruktiv të ndërtesës (p.sh.: ndërhyrje në themele, mure mbajtëse, tra-kolonë etj.)	leke/miratim njoftimi	5000
5.1.4	Pastrim I fasadave	leke/miratim njoftimi	2000
5.1.5	Riparimi dhe zëvendësimi i dritareve e i dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla, si forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente;	leke/miratim njoftimi	2000
5.1.6	Zëvendësimi, riparimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, të pjerrësisë dhe të karakteristikave të veshjes;	leke/miratim njoftimi	5000
5.1.7	Riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve e i oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme;	leke/miratim njoftimi	2000
5.1.8	Riparimi i ballkoneve, terracave dhe bazamakëve apo barrie rave mbrojtëse;	leke/miratim njoftimi	3000
5.1.9	Vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;	leke/miratim njoftimi	1000
5.1.10	Vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;	leke/miratim njoftimi	1000
5.1.11	Sistemimi i shtresave të dheut, por jo betonizimi i tyre	leke/miratim njoftimi	1000
5.1.12	Riparimi i rrethimeve ekzistuese	leke/miratim njoftimi	5000
5.1.13	Realizimi i rrethimeve me struktura të lehta, pa themele.	leke/miratim njoftimi	5000
5.1.14	Shtrimi i oborreve me shtresë të hollë betoni me trashësi ≤ 10cm	leke/miratim njoftimi	5000
5.1.15	Riparimet dhe çarjet pjesore në muret rrethuese, pa cenuar kalimet apo të drejtat e pronave kufitare	leke/miratim njoftimi	3000
5.1.16	Vendosja e parapeteve;	leke/miratim njoftimi	3000
5.1.17	Vendosja e elementëve dekorative arkitektonike në sistemim	leke/miratim njoftimi	2000
5.2	Ndërhyrje të brendshme		
5.2.1	Riparimi dhe rinovimi i dysHEMEVE	leke/miratim njoftimi	2000
5.2.2	Riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;	leke/miratim njoftimi	5000

5.2.3	Riparimi dhe rinovimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave;	leke/miratim njoftimi	3000
5.2.4	Hapja dhe mbyllja e dyerve të brendshme	leke/miratim njoftimi	4000
5.2.5	Krijimi, eliminimi ose ndryshimi i mureve ndarës (jombajtës) të brendshëm;	leke/miratim njoftimi	5000
5.2.6	Realizimi i impianteve të reja higjieno-sanitare dhe të ngrohjes/ftohjes	leke/miratim njoftimi	4000
5.3	Ndërhyrje në impiante higjieno-sanitare dhe elektrike		
5.3.1	Veprat e riparimit dhe të zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit;	leke/miratim njoftimi	2000
5.3.2	Veprat e riparimit dhe të zëvendësimit të pajisjeve elektrike dhe riparimet e sistemeve elektrike	leke/miratim njoftimi	3000
5.4	Punimet civile për rrjetet ose sistemet e komunikimeve elektronike/telekomunikacionit		
5.4.1	Punimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së elementeve ose të rrjeteve të komunikimit elektronik të kufizuara në natyrë/scope dhe në termat e vlerës, madhësisë, impaktit dhe kohëzgjatjes	leke/miratim njoftimi	5000
5.4.2	Punime për përditësimin/upgrade të sistemeve teknike ose të instalimeve ekzistuese me impakt të kufizuar;	leke/miratim njoftimi	5000
5.4.3	Punime civile për ndërhyrje të vogla që janë të kufizuara në natyrë/scope, në termat e vlerës, madhësisë, impaktit ose kohëzgjatjes për shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta	leke/miratim njoftimi	5000
5.5	Punimet civile për rehabilitimin apo rikonstruksionin e infrastrukturës publike kur kryhen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo subjektet e kontraktuara për këtë qëllim, në rastet e mirëmbajtjes së infrastrukturës publike, duke përfshirë sistemim, asfaltim të pjesshëm ose të plotë, ndërtim apo mirëmbajtje trotuaresh, rrjetesh inxhinierike. Ky parashikim zbatohet vetëm për ato punë apo projekte të cilat kanë pasur leje ndërtimi të mëparshme dhe vetëm brenda sipërfaqes së përcaktuar në lejen e ndërtimit.	leke/miratim njoftimi	0(zere)
5.6	Lëvizjet e dheut, që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërhyrjet në impiante hidraulike bujqësore	leke/miratim njoftimi	2000
5.7	Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara.	leke/miratim njoftimi	2000
5.8	Ndërtimi i çative të pashfrytëzueshme në zonat rurale, duke respektuar standardet teknike të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit	leke/miratim njoftimi	10000
6	Tarifë për miratim kerkese per punimet sipas kreut I “Dispozita të përgjithshme” Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisje me lejen dërtimi, VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar VKM Nr.672 datë 29.07.2015, VKM Nr.1043 datë 16.12.2015, VKM Nr.271 datë 6.4.2016, VKM Nr.231 datë 21.03.2017, VKM Nr.355 datë 19.04.2017, VKM Nr. 693, datë 2.10.2019, VKM Nr. 796, datë 11.12.2019, VKM Nr. 457 , datë 29.06.2022 dhe VKM 377 date 12.06.2024 VKM Nr.685, datë 6.11.2024 Neni 6/1 . Ndërhyrje/punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi		

6.1	Punime të jashtme që përfshijnë ndërhyrjet e jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave dhe oborreve/truallit, pjesë përbërëse të tyre, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si:		
6.1.1	Riparimet e objekteve të regjistruara dhe çarjet në muret rrethuese, pa cenuar kalimet apo të drejtat e pronave kufitare;	leke/miratim njoftimi	5000
6.1.2	Vendosja e elementeve dekorative arkitektonike në sistemim	leke/miratim njoftimi	2000
6.1.3	Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara.	leke/miratim njoftimi	2000
7	Punime të jashtme, si ndërhyrjet e mirëmbajtjes së zakonshme, kur sjellin ndryshime të karakteristikave dhe/apo të formave.	leke/miratim njoftimi	5000
7.1	Realizimi i rrethimeve me struktura të lehta, pa themele;	leke/miratim njoftimi	
7.1.1	Shtrimi i oborreve me shtresë të hollë betoni me trashësi ≤ 10cm	leke/miratim njoftimi	5000
7.1.2	Struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe/ose të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, muratura e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 12- mujor nga momenti i lëshimit;	leke/miratim njoftimi	10000
7.1.3	Vendosja e pergolateve, në përputhje me ligjin që rregullon bashkëpronësinë në objektet e banimit;	leke/miratim njoftimi	10000
7.1.4	Mur mbajtës për tarracimet e tokave bujqësore në pronësi, si dhe/apo mur rrethues të tokës bujqësore dhe objekteve në zonat rurale në pronësi, pa shkakuar dëmtim të infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit;	leke/miratim njoftimi	10000
7.1.5	Punime të brendshme, si përforcimi i strukturave mbajtëse të brendshme.	leke/miratim njoftimi	5000
7.1.6	Vendosja e serrave të çmontueshme, pa themele të vazhduara, në shërbim të aktiviteteve bujqësore	leke/miratim njoftimi	5000
7.1.7	Lëvizjet e dheut, që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërhyrjet në impiante hidraulike bujqësore	leke/miratim njoftimi	5000
8	Tarifë konfirmimi plan rievimi për ndërtesat ekzistuese dhe te reja	leke	2000
9	Tarifë konfirmimi plan rievimi për tokat bujqësore	leke	1000
10	Tarife konfirmimi per plan vendosje per ndërtesat ekzistuese dhe te reja	leke	1000
11	Leshim vertetimi per andres per brenda dhe jashte vendit	leke	100
12	Tarifë për dhënie dokumenta nga arkiva D.P&ZH.T.		
	a.Fotokopje e njësuar A3	leke	200
	b.Fotokopje e njësuar A4	leke	100
	c.Fotokopje të studimeve urbanistike në fuqi A4	leke	300
	d.Fotokopje të studimeve urbanistike në fuqi A4	leke	500
<i>Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen.Drejtoria e Planifikimit Territorit,Drejtoria e Financës dhe Tatim Taksave</i>			

I.5 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

1. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
2. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
3. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhitin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Nr	Kategoritë e ndërtesave	Lekë /m2
I	Ndërtesë Banimi	100
II	Ndërtesa të t.j.tregti dhe shërbime, perfshi dhe zyra	300
III	Ndërtesa të tjera	200

I.6 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit është taksë vjetore për çdo vit kalendarik nga 1 janari deri më 31 dhjetori të vitit përkatës, për të cilën llogaritet dhe paguhet dhe ka vlefshmëri 365 ditë, pavarësisht nga momenti në të cilën ajo paguhet. Kjo taksë caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12.5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. "Viti i vjetërsisë" është diferenca ndërmjet vitit, kur mjetit i lind detyrimi për të kryer pagesën e taksës me vitin e prodhimit. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit

Të ardhurat nga TVMP-ja, për çdo rast mbledhen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, dhe shpërndahen sipas procedurave të përcaktuara. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën ndarjen e të ardhurave nga TVMP-ja për secilën njësi të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit sipas regjistrimit të gjendjes civile ose adresës së ushtrimit të aktivitetit sipas adresës në QKB, sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Nga shuma mujore e arkëtimeve nga TVMP-ja, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5(pesë)% të totalit mujor të arkëtimeve, 25 (njëzet e pesë)% e diferencës (25% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) të arkëtimeve e derdhitin në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore. Pjesa tjetër e mbetur prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) % (75% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) paguhet për llogari të drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar DPSHTRR-ja (Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj) brenda datës 15 të muajit pasardhës.

I.7 Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licënsuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka.

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të

ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Cërrik në llogarinë e degës së thesarit.

I.8 Taksa e tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njesisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike tëlejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi. Vendosija e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve.

Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kontrollit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Cërrik është si më poshtë:

Llojet e tabelave	Njesia	Niveli i taksës
I. Tabelë për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti I biznesit).		
a- Deri 2m ²	Lekë/m ² /vit	0
Mbi 2m ² deri 10 m ²		
- E thjeshte (pa ndricim)	Lekë/m ² /vit	7000
- Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	11500
- Elektronike	Lekë/m ² /vit	15000
Mbi 10 m ² deri 20 m ²		
- E thjeshte (pa ndricim)	Lekë/m ² /vit	5950
- Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	9775
- Elektronike	Lekë/m ² /vit	12750
Mbi 20 m ² deri 40 m ²		
	Lekë/m ² /vit	3850
	Lekë/m ² /vit	6325
	Lekë/m ² /vit	8250
Mbi 40 m ²		
	Lekë/m ² /vit	2800
	Lekë/m ² /vit	4600
	Lekë/m ² /vit	6000
II-Tabel për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
- Tabele identifikuese	Lekë/m ² /vit	120
II-Tabel për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe epalëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m ²		
- Tabelë e thjeshtë (pa ndricim)	Lekë/m ² /vit	13500
- Tabelë elektronike	Lekë/m ² /vit	27000
III- Tabelë ne funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola		
- të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë/m ² /ditë	1000

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do ti shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes deri 10m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë dhe për sipërfaqet mbi 20m² dhe mbi 40m².

I.9 Taksa vendore mbi të ardhurat personale.

Baza ligjore: Ligji nr.68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/e, 25 pika 2/ç.

Taksa vendore mbi të ardhurat personale hyn në kategorinë e “taksave të ndara”. Është taksë kombëtare që një përqindje të saj e marrin njësitet e vetëqeverisjes vendore për të ardhurat që realizohen në

juridiksionin e tyre. Bashkisë Cërrik i kalon një përqindje prej 2% e të ardhurave nga tatimi

mbi të ardhurat personale. Udhëzimi mbi përçesuraturat e ndjekjes deri në kalimin e kësaj të ardhura në llogari të Njësive Vendore bëhet sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave.

I.10 Taksa e arsimit

Taksa të tjera :

Taksa e Arsimit për çdo subjekt te detajuar:

Të gjitha taksat të cilat propozohen në këtë kapitull, janë sipas vlerësimit të kryer mbi bazë kostoje të komisionit të ngritur me urdhër të posaçëm. ligji 68/2017 “Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”, neni 13”Rregulla për vendosjen e taksave të përkohëshme vendore”:

a-percaktimi i investimit që do financohet

b-kohezgjatja jo me shume se tre vjet

c-kostot e afatet e kryerjes se investimit

-Ky plan i paraqitet komunitetit vendor në, të paktën, tre konsultime publike, të kryera në një periudhë jo më pak se pesë muaj.

-Baza e llogaritjes së taksës së përkohshme për çdo tatimpagues është vlera e taksës së pasurisë së paluajtshme të tatimpaguesit në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Niveli i taksës së përkohshme nuk mund të jetë më i lartë se 35% e bazës së taksës,

-Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të aplikojnë me shumë se dy taksa të përkohshme gjatë një viti buxhetor.

Niveli i taksës: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

	Familjet	CERRIK	MOLLAS	GOSTIM	KLOS	SHALES	TOTALI	T.Arsimi	Totali
1	Familje Cerrik	2559					2559	100	2559
2	Familje NJA		961	2206	745	1088	5000	100	5000
	Biznese 0-8 Million lek	CERRIK	MOLLAS	GOSTIM	KLOS	SHALES	TOTALI		755.9
1	Njësi tregtimi për bulmet, mish, peshk	11					11	1000	11000
2	Për njësitë administrative e periferi		5	7	3	4	19	1000	19000
3	Njësi tregtimi fruta perime, artikuj ushqimore të ndryshëm (shumicë)	2		1			3	1000	30000
4	Njësi tregtimi fruta perime, artikuj ushqimore të ndryshëm (pakicë)	18					18	1000	180000
5	Njësi tregtimi fruta perime, artikuj ushqimore të ndryshëm (NJA dhe periferi)		13	18	11	9	51	1000	510000
6	Njësi tregtimi për artikuj industrialë (shumicë)							0	
7	Njësi tregtimi për artikuj industrialë (pakicë)	19				1	20	1000	200000
8	Njësi tregtimi për artikuj industrialë (NJA dhe periferi)		7	11	3	3	24	1000	240000
9	Restorant bar kafe (njësitë e mëdha)	10					10	2000	200000
10	Restorant bar kafe (njësitë e vogla)	29					29	1000	290000
11	Restorant bar kafe (NJA dhe periferi)		13	45	7	18	83	1000	830000
12	Lojrat për fëmijë	1		1			2	1000	20000
13	Bilardo			1		1	2	1000	20000
14	Hotele, motele, komplekse turistike	1		1	1		3	2000	60000
15	Subjekte peshkimi (deri 10ha)	1		4		1	6	1000	60000
16	Subjekte peshkimi (deri 11-15 ha)			1			1	1000	10000
17	Subjekte peshkimi (16-20ha)							0	
18	Subjekte peshkimi (> 20 ha)					1	1	1000	10000
19	Tregti material ndërtimi	1	1	1			3	2000	60000
20	Tregti input bujqësore, famarci bujqësore	5	6	6		2	19	1000	190000
21	Shërbim internet kabllor, lavazh servis automjetesh	13	7	11	2	5	38	1000	380000
22	Njësi shërbimi artizanati, shërbim funeral	2		1			3	1000	30000
23	Profesione të lira	32	10	31	7	6	86	1000	860000
24	Mobileri, punime mermeri	16	5	9	1	5	36	2000	720000

25	Prodhim fidanësh	4	1				5	1000	5000
26	Njësi prodhimi furrë buke/ ëmbëltore	20					20	1000	20000
27	Njësi prodhimi furrë buke/ ëmbëltore (NJA dhe periferi)		4	7		3	14	1000	14000
28	Transport udhëtarësh derin në 5 vende	8					8	1000	8000
29	Transport udhëtarësh derin në 6-9 vende	2					2	1000	2000
30	Transport udhëtarësh derin në 10-42 vende	11					11	2000	22000
31	Transport mallrash deri në 5 ton	9					9	1000	9000
32	Ambulantë	10					10	1000	10000
	TOTALI	225	72	156	35	59	547		1.365.500

	Biznese > 8 Million lek dhe institucione	CERRIK	MOLLAS	GOSTIM	KLOS	SHALES	TOTALI	T.Arsimi	Totali
1	Supermarkete	2		2			4	10000	40000
2	Hidrocentrale deri 2 mw			1			1	500000	500000
3	Hidrocentrale mbi 2 mw			1			1	1500000	1.500.000
4	Gurore				2		2	50000	100000
5	Shfrytëzim lumi		2				2	30000	60000
6	Subjekte tregtimi	2	2	2		1	7	10000	70000
7	brigade ndërtimi/mirembatje rrugesh/germim dheu/Transport mallra/	10	2	2	1	2	17	5000	85000
8	Farmaci, Qendra rehabilitimi psikiatrik,Klinike dentare/Ujësjiellës Kanalizime/Klinike mjekesore/Internet Kabllor /Autoshkolla	14	4	5	1	3	27	5000	135000
9	Klinike e konsulta mjekesore	1					1	10000	10000
10	Subjekte të tjera	3	2	4	1	1	11	10000	110000
11	Njesi prodhimi/Transferta parash/Tregti mater.nderet/Përpunim mermeri/Panele Diellore/Banka niveli I dyte e trete/Shoqerite telefonike/	11	4	4	1	1	21	10000	210000
12	Përpunime duro-alumin/kultivim e tregti bime decorative,fidane/Fabrika vaj-ulliri/Kultivim e tregtim duhani/	7	5	8	4	5	29	10000	290000
13	Tregti mallra ushqimor e industrial me shumicë e pakicë/minimarket/	2	2	3	1	2	10	10000	110000
14	Tregti me pakice te karburanteve/gazi natyror/	5	4	4	1	2	16	10000	160000
15	Institucione shtetërore	17					17	5000	85000
16	SHA te ndryshme	2	1	1		1	5	10000	50000
17	Nipt fermri, nipt online	4	4	2	5	2	17	5000	85000
18	Koncesionarë dhe fasoneri	1		1			2	10000	20000
	TOTALI	83	32	40	17	20	192		3.620.000
	TOTALI	308	104	196	52	79	739		5.741.800

Kapitulli II: Tarifat vendore

Në bazë të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , neni 35 ‘Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore’, Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për:

- a) shërbimet publike që ato ofrojnë;
- b) të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;
- c) dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;
- ç) çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara me ligj.

Llojet e tarifave subjekt i këtij vendimi janë:

1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave ,mbrojtjes dhe permiresimit ne mjedis.
2. Tarifa për zënien e hapsirave Publike
3. Tarifa në fushën e transportit.
4. Tarifa të urbanistikës.
5. Tarifa për lëshimin e vërtetimeve.
6. Tarifa e vaditjes.
7. Tarife për dhënien e dokumentave nga arkiva
8. Tarife për dhënien e liçensave të tregtimit të karburanteve.
9. Tarifa e ndricim
10. Tarifa e gjelbërimit
11. Tarifa të tjera
12. Dhënia me qera e aseteve në pronësi ose në përdorim
13. Tarifa në sektorin e pyjeve dhe kullotave

II.1 Tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave ,mbrojtjes dhe permiresimit te mjedisit.

